

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Alcora Lounge" shpk

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1) Sot, më 12.11.2024, themeluesi, kemi kriuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**"Alcora Lounge"**.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:

Z. Isuf Dautaj, atësia Nezir, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13.11.1991 lindur dhe banues në Has, identifikuar me numër personal J11113032C

Neni 2:
Objekti

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
- 2) Te ushtroje aktivitetin ne fushen bar-restoran si dhe cdo veprimatri tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise dhe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.

Sidoqoftë asgje nuk do te interpretohet ketu si kufizim i mundesise se shoqerise per te hyre ne tregje apo aktivitete dhe operacione te tjera tregtare pavaresisht se keto aktivitete te mundshme nuk jane permendur ketu shprehimi.

Neni 3:
Kohëzgjatja

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4:
Selia

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Shqiperi,Tirane,Bulevardi "Deshmoret e Kombit " Kullat Binjake ,Kati 3,Zona Kadestrale 8270,Nr I pasurise 3/239+2-N31/1.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

KREU II
KAPITALI

Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njeqin mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (Nje) kuote. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Isuf Dautaj, zotërues i 1 (Nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njeqind mijë) Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve do te jetë ne para te cilat janë paguar.

Neni 6:

Faqe 1 e 6

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
shpk

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar përkontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.
- 4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse përmarrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Faqe 2 e 6

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

_____ shpk

Neni 9
Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kuorumi

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërat e votave te zotëruar te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.


Neni 12
Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Z. Isuf Dautaj, atësia Nezir_shtetas_Shipatre, identifikuar me anë me numër personal identifikimi J11113032C i datëlindjes 13.11.1991, lindur në Has dhe banues në Has, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

Faqe 3 e 6
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
_____ shpk



- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 4) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14
Kompetencat e Administratorit

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmiratuese, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratuar e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përmiratues të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përmiratues të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15
Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, përmiratues të statutit, apo përmiratues të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuar nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, përmiratues të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdijis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm përritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, përmiratues të merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

Faqe 4 e 6
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

shpk

- e) tē ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave tē tij, përgjigjen ndaj shoqërisë pér çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në ményrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim tē rasteve kur, në bazë tē hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi eshtë kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 tē këtij neni, eshtë i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës pér të vërtetuar kryerjen e detyrave tē tyre në ményrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja eshtë kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në ményrë solidare.
- 6) Në ményrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshtë i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria tē vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë tē gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do tē kishte aftësi paguese pér tē shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë pér shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë tē drejtë tē ngrënë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë tē drejtë tē ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë tē dëmit që i eshtë shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse eshtë e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund tē ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit pér gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit tē detyrës.

**KREU IV
VITI FINANCIAR, EKSPERTET**

Neni 16

Viti Financiar

- 1) Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

**KREU V
PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

Neni 17

Prishja dhe likuidimi

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund tē behet ne çdo kohe:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave tē falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare pér dy vjet dhe nuk eshtë njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim tē gjykatës;
- 2) Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne tē cilin parashikojnë ményrën e likuidimit tē shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument tē nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tē likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim tē rasteve kur eshtë nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortaket nuk marrin një vendim pér emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, pér tē caktuar një likuidues.

*Faqe 5 e 6
Statut i shoqërisë me përgjegjësi tē kufizuar
shpk*

Neni 18
Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asambleës së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."


Neni 19
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 20
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAKËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Alcora Lounge" shpk

ISLIF DAUTA

(Emër, Mbiemër, Nënshtërimi)